



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 39/3 prot.

Tiranë më 13.2.2018

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 13.2.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE.

Baza Ligjore: Ligji Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, nenet 30, 31 dhe 32 të tij.

Në zbatim të Urdhrit Nr.13, datë 10.01.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Përmbaruesit Privat "Dominus" sh.p.k. Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Zyra Përmbarimore Private "Dominus" sh.p.k. Tiranë.

Në funksion të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Zyrat Përmbarimore Private, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe grumbullojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe përmbarues gjyqësor" dhe "subjekte që marrin pjesë në ekzekutim".

Kontrolluesi "Dominus" sh.p.k. është subjekt juridik me NIPT: I22404003E, dhe objekt aktiviteti, "Shërbim përmbarimor privat".

Kontrolluesi "Dominus" sh.p.k. Tiranë, në ushtrim të detyrës së tij, ka kryerjen e shërbimit përmbarimor privat gjyqësor dhe konkretisht, ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në rastet e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile.

Përfaqësuesi i kontrolluesit u njoh me Urdhrit Nr.13, datë 10.01.2018 të Komisionerit dhe ishte bashkëpunues me grupin e inspektimit.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim, në datë 22.01.2018 u konstatua:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 të ligjit. Ky formular duhet të përditësohet (neni 22), e konkretisht rubrika 5.1 "Të dhëna sensitive që përpunohen", dhe rubrika 7.1 "Marrësi i të dhënave personale".
2. Kontrolluesi ka hartuar rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
3. Në kontratat me palët e treta, për ofrimin e shërbimeve të zyrës përmbarimore në lidhje me mbledhjen e detyrimeve të prapambetura etj., midis palëve është hartuar marrëveshje bashkëpunimi për shërbimet e përbashkëta, konstatohet se janë mbajtur parasysh detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin Nr.19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi".
4. Kontrolluesi nuk ka publikuar "Politikat e Privatësisë" në portalin zyrtar të <http://www.dominus.al>. Informacioni i publikuar në rubrikën "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative, konkretisht të neneve:

- Konstatimi i pikës së parë përbën shkelje administrative të nenit 22 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.
- Konstatimi i pikës së katërt përbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në përfundim të hetimit administrativ pasi u mbajt procesverbali për konstatimet e gjetura nga ana e grupit të hetimit, përfaqësuesi i kontrolluesit u shpreh:

"Angazhohemi që të plotësojmë të gjitha rekomandimet e grupit të kontrollit në një kohë sa më të shkurtër".

Ligji Nr.10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat" i ndryshuar dhe konkretisht neni 36 i tij "Konfidencialiteti" shprehet:

"Përmbaruesi gjyqësor privat, i cili merr informacionet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ruan fshehtësinë e tyre dhe nuk duhet t'ua japë këto informacione të tretëve, përveç:

- a) *organeve të rendit publik, prokurorisë ose gjykatës;*
- b) *strukturave të tjera shtetërore, lidhur me çështjet pasurore të debitorëve;*
- c) *përmbaruesve të tjerë, vetëm nëse informacioni është i nevojshëm për procedurat e ekzekutimit;*
- ç) *kreditorit, i cili ka depozituar për ekzekutim një titull ekzekutiv;*
- d) *kur personi, për të cilin kërkohet informacioni, jep pëlqimin".*

- Gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të ligjshëm, kontrolluesi “*Dominus*” sh.p.k. Tiranë, përveç informacionit që grumbullon me të dhëna të zakonshme apo gjeneralitetet, grumbullon dhe të dhëna sensitive siç mund të jetë dënimi penal, dhe që nuk është pasqyruar në Formularin e Njoftimit, sipas rubrika 5.1 të këtij formulari.
- Gjithashtu, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij të ligjshëm, kontrolluesi “*Dominus*” sh.p.k. Tiranë, për detyrime ligjore të ndryshme kryen dhe përhapje të dhënash, fakt që nuk është pasqyruar në Formularin e Njoftimit, sipas rubrikës 7.1 të këtij formulari.

Neni 22 i ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, detyron çdo kontrollues të deklarojë në Formularin e Njoftimit, si më poshtë:

“Njoftimi duhet të përmbajë:

- a) emrin dhe adresën e kontrolluesit;*
- b) qëllimin e përpunimit të të dhënave personale;*
- c) kategoritë e subjekteve të të dhënave dhe kategoritë e të dhënave personale;*
- d) marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave personale;*
- e) propozimin për transferimet ndërkombëtare që kontrolluesi synon të kryejë;*
- f) një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale”.*

- Konstatimi i pikës 4 të procesverbalit, përmbën shkelje administrative të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, i cili shprehet si vijon:
- “1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t’i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit...”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 3/4, 18, 22, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, Zyra Përmbartimore Private “*Dominus*” sh.p.k. Tiranë, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, të realizojë në vazhdimësi përditësimin e Formularit të Njoftimit, duke pasqyruar në të çdo ndryshim të mundshëm të aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi, Zyra Përmbartimore Private “*Dominus*” sh.p.k. Tiranë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, të hartojë dhe publikojë në portalin zyrtar të tij: <http://www.dominus.al>, rubrikën “*Politikat e Privatësisë*”.
3. Kontrolluesi, Zyra Përmbartimore Private “*Dominus*” sh.p.k. Tiranë, ka detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të

Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë rekomandim, brenda 5 ditëve nga marrja e këtij rekomandimi.

4. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 13.2.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

